

Gjykata Supreme e Kosovës
Pkl-Kzz nr. 188/2012
12 dhjetor 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Horst Proetel si kryetar i kolegjit, Gjyqtarëve të EULEX-it Martti Harsia dhe Gerrit-Marc Sprenger dhe të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme Avdi Dinaj dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit të ndihmuar nga zyrtarja ligjore Chiara Rojek duke vepruar në cilësinë e procesmbajtëses,

Në lëndën penale P nr. 766/2012 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër

(N.A.K.)

1)

I akuzuar sipas aktakuzës PPS nr. 07/10 të parashtruar nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës (PSRK) më 25 korrik 2011 me veprat penale **Krime Luftë kundër Popullsisë Civile dhe Krime të Luftës kundër të Burgosurve të Luftës** në kundërshtim të neneve 22, 142 dhe 144 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), e dënueshme me nenet 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në kundërshtim të Nenit të përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe të neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (PShII) (pika 1), **Krime Luftë kundër Popullsisë Civile** në kundërshtim të neneve 22, 142 të KP të SFRJ-së, e dënueshme me nenet 23 dhe 120 të KPK-së (pika e akuzës 2), dhe të katër pikave të akuzës **Krime Luftë kundër të Burgosurve të Luftës** në kundërshtim të neneve 22, 144 të KP të RSFJ-së, e dënueshme me nenet 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe të neneve 4, 5 (1) të PShII (pikat 3 deri 6),

(Ne.K.) 2)

I akuzuar sipas aktakuzës PPS nr. 07/10 të parashtruar më 25 korrik 2011 me veprat penale **Krime Luftë kundër Popullsisë Civile dhe Krime të Luftës kundër të Burgosurve të Luftës** në kundërshtim të neneve 22, 142 dhe 144 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), e dënueshme me nenet 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në kundërshtim të Nenit të përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe të neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (PShII) (pika 1), pesë pikave të akuzës për **Krime të Luftës kundër të Burgosurve të Luftës** në kundërshtim të neneve 22, 144 të KP të RSFJ-së, e dënueshme me nenet 23, 120 të KPK-së në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe nenet 4 dhe 5 (1) të PShII (pikat 2, 3, 4, 5 dhe 7), dhe **Krime Luftë kundër Popullsisë Civile** në kundërshtim të neneve 22, 142 të KP të RSFJ-së, e dënueshme me nenet 23 dhe 120 të KPK-së (pika 6),

(FL) 3)

I akuzuar sipas aktakuzës PPS nr. 07/10 e parashtruar më 25 korrik 2011 me veprat penale **Krime Luftë kundër Popullsisë Civile dhe Krime të Luftës kundër të Burgosurve të Luftës** në kundërshtim të neneve 22, 142 dhe 144 të KP të RSFJ-së, të dënueshme me nenet 23 dhe 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5(1) të PShII (pika 1), dhe dy pikave të **Krime të Luftës kundër të Burgosurve të Luftës** në kundërshtim të neneve 22, 144 të KP të RSFJ-së, të dënueshme me nenet 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe nenet 4 dhe 5 (1) të PShII (pikat 2 dhe 3), dhe

N.S.

I akuzuar sipas aktakuzës PPS nr. 07/10 e parashtruar më 25 korrik 2011 me veprat penale **Krime Luftë kundër Popullsisë Civile dhe Krime të Luftës kundër të Burgosurve të Luftës** në kundërshtim të neneve 22, 142 dhe 144 të KP të RSFJ-së, të dënueshme me nenet 23 dhe 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5(1) të PShII (pika 1), katër pikave **Krime të Luftës kundër të Burgosurve të Luftës** në kundërshtim të neneve 22, 144 të KP të RSFJ-së, të dënueshme me nenet 23, 120 të KPK-së, në kundërshtim të nenit të përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe nenet 4 dhe 5 (1) të PShII (pikat 2, 3, 4 dhe 6), dhe **Krime Luftë kundër Popullsisë Civile** në kundërshtim të neneve 22, 142 të KP të RSFJ-së të dënueshme me nenet 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (pika 5).

F.L.

M.H.

F.V.

N.S.

Xh.M.

Ne.K.

Duke vepruar sipas Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë (Kërkesa) e parashtruar më 29 nëntor 2012 nga avokatët mbrojtës [redacted] dhe [redacted] në emër të pandehurit [redacted] kërkesa e parashtruar më 30 nëntor nga avokati mbrojtës [redacted] në emër të pandehurit [redacted] kërkesa e parashtruar më 3 dhjetor nga avokati mbrojtës [redacted] në emër të pandehurit [redacted] dhe kërkesës së parashtruar më 3 dhjetor nga avokati mbrojtës [redacted] në emër të [redacted] kundër aktvendimit P nr. 766/2012 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 24 nëntor 2012 me të cilin është shqiptuar paraburgimi për një periudhë kohore një-mujore deri më 24 dhjetor 2012 kundër katër të pandehurve të lartpërmendur dhe kundër aktvendimit Pn-Kr nr. 967/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27 nëntor 2012 me të cilin janë refuzuar të gjitha ankesat e mbrojtjes kundër aktvendimit P nr. 766/2012 të Gjykatës së Qarkut dhe duke e marrë parasysh opinionin dhe propozimin e parashtruar nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK-ja) të datës 11 dhjetor 2012, pas shqyrtimit dhe votimit më 12 dhjetor 2012,

Na.K.

B.T.

T.R.

Në pajtim me nenin 451 dhe vijues të KPPK-së, merr këtë

Ne.K.

F.L.

N.S.

AKTGJYKIM

1. Katër Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshmërisë të parashtruara për të pandehurit [redacted] dhe [redacted] kundër aktvendimit P nr. 766/2012 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 24 nëntor 2012 dhe aktvendimit Pn-Kr nr. 967/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27 nëntor 2012 janë **REFUZUAR** si të pabazuara.

2. Të dy aktvendimet janë **KONFIRMUAR** në tërësinë e tyre.

Na.K.

ARSYETIMI

I. Historiku i procedurës

Më 25 korrik 2011, Prokurori Special ka ushtruar aktakuzën PPS nr. 07/2010 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër të pandehurve [redacted] dhe të tjerët për veprat e lartpërmendura penale. (N.S.) (Na.K.) (Ne.K.) (F.L.)

Më 26 gusht 2011, aktakuza është konfirmuar në tërësi me aktvendimin KA nr. 505/11. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 11 nëntor 2011. Më 21 mars 2012, trupi gjykues ka lëshuar aktvendim mbi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të [redacted] kështu duke deklaruar të papranueshme të gjitha deklaratat e dhëna nga i ndjeri dëshmitari X. (A.Z.)

Më 2 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka lëshuar aktgjykimin P nr. 425/11 me të cilin të katër të pandehurit janë liruar nga të gjitha akuzat.

Më 20 nëntor, Gjykata Supreme e Kosovës pjesërisht ka aprovuar ankesën e Prokurorit Special dhe e ka kthyer lëndën për rigjykim.

Më 24 nëntor, pas seancën dëgjimore për paraburgim, kryetari i kolegjit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, me aktvendimin P nr. 766/2012, ka shqiptuar paraburgim për [redacted] për periudhë një-mujore deri më 24 dhjetor. (Na.K.) (Ne.K.) (F.L.) (N.S.)

Më 27 nëntor, kolegji i Gjykatës Supreme ka refuzuar ankesat e parashtruara nga të pandehurit përmes avokatëve të tyre mbrojtës kundër aktvendimit të 24 nëntorit.

II. Parashtrësat e palëve

Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshëmrisë të parashtruara nga Mbrojtja

Avokatët mbrojtës [redacted] dhe [redacted] të [redacted] kanë parashtruar kërkesë kundër të dy aktvendimeve për shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1, nën-paragrafit 12 dhe paragrafit 2 nën-paragrafit 1 të KPPK-së dhe shkeljeve tjera të ligjit të procedurës penale sipas nenit 270, nenit 281 paragrafit 1 nën-paragrafëve 1 dhe 2 (i), (ii) dhe (iii) të KPPK-së. Ata propozojnë që të ndryshohen aktvendimet e kontestuara dhe të ndërpritet masa e paraburgimit, ose të anulohen ato dhe të kthehet lënda mbrapa për rivendosje. (E.V.) (Xh.M.) (Na.K.)

Mbrojtja pretendon që aktvendimi i shkallës së parë është shkruar në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte dhe përveç kësaj nuk përmban arsye dhe fakte të veçanta sa i përket ekzistimit të dyshimit të bazuar¹ dhe të kërkesave tjera. Janë bërë shkelje substanciale pasi që kërkesat për urdhër të arrësit nuk janë përmbushur dhe se kryetari i kolegjit të Gjykatës së Qarkut nuk ka qenë në posedim të shkresave të lëndës. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) sa i përket rrezikut të ikjes² dhe nuk ka arritur ti marr parasysh elementet esenciale siç është situata familjare e të pandehurit³. Shqiptimi i paraburgimit i bazuar në rrezikun e pengimit të provave është joligjor dhe nuk qëndron pasi që dëshmitarët tjerë janë të mbrojtur dhe janë anonim.⁴ Sa i përket aktvendimit të Gjykatës Supreme, dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin, posaçërisht pasi që gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktvendimin e shkallës së parë duke e shkelur nenin 425 të KPPK-së. Për më tepër, kolegji i Gjykatës Supreme nuk ka arritur të ofrojë shpjegime mbi kërkesat tjera për shqiptimin e paraburgimit dhe të

¹ GjEDNj, Cebatar kundër Moldavisë, Aktgjykimi i datës 13 nëntor 2007, paragrafi 48

² GjEDNj, Muller kundër Francës, Aktgjykimi i datës 17 mars 1997, paragrafi 43

³ GjEDNj, Letellier v France, Aktgjykimi i datës 26 qershor 1991

⁴ GjEDNj, Tomasi v France, Aktgjykimi i datës 27 gusht 1992, paragrafët 92-95

përgjigjet në argumentet e mbrojtjes⁵. Duke iu referuar aktvendimit Pn-Kz 222/11 të Gjykatës Supreme të datës 22 prill 2011, mbrojtja e kundërshton ekzistimin e rrezikut të përsëritjes. Mbrojtja përfundimisht e kundërshton referencën e Gjykatës Supreme të Kosovës në shqetësimet politike.

(M.H)

(Ne.K.)

Avokati [REDACTED] i të pandehurit [REDACTED] parashtroi kërkesë kundre dy aktvendimeve për shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 12 i lidhur me nenin 451 paragrafin 1 nën-paragrafin 2 dhe paragrafin 4 të KPPK-së dhe i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës të ndryshoj aktvendimin duke e liruar të pandehurin ose të shqiptojë masë alternative (dorëzani apo masën e arrestit shtëpiak).

Sipas këndvështrimit të mbrojtjes, mungesa e arsytimit në aktvendime lidhur me arsyet e shqiptimit të paraburgimit dhe gjithashtu të individualizimit. Standardet e të drejtave të njeriut që janë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në GjEDNj⁶ janë shkelur e posaçërisht nga gjykata e shkallës së dytë. Gjykata e shkallës së parë ka përdorur praktikën e harruar të nenit 191 paragrafit 1 pikës 1 të Ligjit të Procedurës Penale të RSFJ0së duke ofruar për shqiptimin mandatorë të paraburgimit. Ashpërsia e jashtëzakonshme e dënimit nuk përbën bazë për urdhërimin e paraburgimit. Avokati mbrojtës i referohet dy aktvendimeve të lëshuara nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë⁷. Ai e vë në pah që [REDACTED] nuk ka tentuar të ik dhe i përmend kushtet e familjes së të pandehurit. Përfundimisht, gjykata duhet të qëndroj anash nga çfarëdo ndikimi politik.

(Ne.K)

Avokati mbrojtës [REDACTED] i [REDACTED] ka parashtuar kërkesë kundër aktvendimit Pn-Kr nr. 967/2012 të datës 27 nëntor për shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 10, 11 dhe 12 dhe paragrafit 2 i lidhur me nenin 281 paragrafin 1 nën-paragrafin 2 (i), (ii), dhe (iii) të KPPK-së dhe propozon që të ndryshohet aktvendimi i kundërshtuar duke e ndërprerë masën e paraburgimit ose të shqiptojë masë më të butë për të pandehurin.

(T.R)

(F.L)

Mbrojtja pretendon që dispozitivi i aktvendimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm, kontradiktorë me përmbajtjen e tij dhe të arsytimit të dispozitivit, veçanërisht pasi që Gjykata Supreme ka konstatuar që nuk duhet të diskutohet rreziku i ikjes sepse është përmbushur kusht tjetër i nenit 281 paragrafit 1 nën-paragrafit 2. Arsyetimi nuk ofron arsyet për faktet vendimtare dhe në argumentet e mbrojtjes të paraqitura në ankesa në kundërshtim me nenin 403 paragrafin 2 e lidhur me nenin 396 paragrafët 6 dhe 7 të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme e ka plotësuar arsyetimin e aktvendimit të kontestuar në dëm të pandehurit duke shkelur kështu nenin 403 i lidhur me nenin 417 të KPPK-së. I pandehuri në mënyrë strikte i është bindur kushteve të arrestit shtëpiak. Rreziku i shkatërrimit të provave nuk ekziston pasi që të gjithë dëshmitarët kryesorë janë të mbrojtur dhe sa i përket kësaj kolegji i Gjykatës Supreme në mënyrë të gabuar ka vlerësuar deklaratën e dëshmitarit X. Kritika e politikanëve kundër gjyqësorit të EULEX-it nuk mund të merret si presion mbi dëshmitarët *per se*. Së fundmi, Gjykata Supreme e Kosovës e ka bazuar vlerësimin e saj mbi supozime dhe thashetheme.⁸

⁵ Në lëndën ILjkov kundër Bullgarisë, ESLJP. Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 26 qershor 2001.

⁶ Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave Fundamentale e datës 4 nëntor 1950

⁷ Gjykata e Qarkut në Mitrovicë. Aktvendimi GJPP nr. 96/12 i datës 6 nëntor 2012 dhe aktvendimi KP nr. 386/12 i datës 21 nëntor 2012

⁸ Lënda e GjEDNj Blastland kundre MB (Mbretërisë së Bashkuar) (52 DR 273); pranimi i thashethemeve si prova nuk është në parim në kundërshtim të garantimit të procesit të rregullt, por nëse nuk ekziston mundësi për kryerjen e hetimeve, kjo mund të prodhoj gjykimin e padrejtë.

F.L

N.S

Na.K.

Kërkesat janë paraqitur pranë shkrimores më 29 nëntor (për [redacted]), më 30 nëntor (për [redacted]) dhe më 3 dhjetor (për [redacted] dhe [redacted]). — Ne.K.
Katër kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë paraqitur brenda afatit të përcaktuar prej tre muajve pas dorëzimit të vendimit të formës së prerë, sipas neneve 451 paragrafit 4 dhe 452 paragrafit 3 të KPPK-së.

Meritat e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë


Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se kryetari i kolegjit i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ka qenë gjyqtar kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën për paraburgim të paraqitur nga Prokurori Special më 20 nëntor. Dispozitat e nenit 424 paragrafit 1, 428 paragrafit 1 dhe 429 paragrafit 1 përcaktojnë kthimin e lëndës në gjykatën e shkallës së parë e cila do të procedohet 'në bazë të aktakuzës së mëhershme. Gjithashtu, neni 429 paragrafi 5 i KPPK-së i cili përcakton "në qoftë se i akuzuari është në paraburgim, kolegji i gjykatës së shkallës së parë procedon sipas nenit 287, paragrafi 2 i këtij Kodi" nuk jep hapësirë për ndonjë interpretim: trupi gjykues apo kryetari i kolegjit kur kolegji nuk është në seancë, ka kompetenca për të vendosur lidhur me çështjet e paraburgimit pas kthimit të lëndës në shkallën e parë. Si rrjedhojë, kolegji i Gjykatës Supreme refuzon pretendimet e mbrojtjes në lidhje me këtë.

Gjykata Supreme gjithashtu i konsideron si jomeritore argumentet e mbrojtjes në lidhje me lëvizjen fizike të shkresave të lëndës në kundërshtim të nenit 428 të KPPK-së. Është e qartë se kjo dispozitë është e aplikueshme vetëm kur Gjykata Supreme lëshon vendimin ("një numër i mjaftueshëm i kopjeve të vendimit të saj"). Kjo nuk është e pazakontë në lëndë komplekse sikur që është lënda në fjalë, e cila përfshinë shumë të pandehur, që shkresat e lëndës të jenë në shkallën e parë dhe shkallën e dytë në të njëjtën kohë për shkak të njëkohshmërisë së ankesave/kërkesave të paraqitura nga palët. Fakti se shkresat e lëndës nuk janë kthyer në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut dhe kanë mbetur në hapësirat e Gjykatës Supreme para lëshimit të aktvendimit mbi paraburgimin nuk ndikon në ligjshmërinë e vendimit, përderisa gjyqtari kompetent ka pasur qasje në shkresat e lëndës për të proceduar me vlerësimin ligjor dhe faktik dhe për të vendosur në lidhje me këtë.

Ky kolegji nuk sheh asnjë kundërthënie apo mospërputhje në dispozitivin e aktvendimeve të kundërshtuara ose në mes të diapozitivave dhe arsytimit. Ato janë të qarta dhe të kuptueshme. Pretendimi se aktvendimi është në kundërshtim të nenit 396 paragrafëve 6 dhe 7 të KPPK-së është jo relevant pasi që kjo dispozitë është e aplikueshme në mënyrë specifike për 'përpilimin dhe dorëzimin e aktgjytimeve', dhe jo aktvendimeve.

Është vërejtur se gjykata e shkallës së dytë ka plotësuar aktvendimin e shkallës së parë me arsytime të mëtutjeshme lidhur me rrezikun e ndikimit të dëshmitarëve.⁹ Ky kolegji i Gjykatës Supreme konsideron se gjykata e apelit ka të drejtë në ndryshime të tilla gjykatës së shkallës së parë siç është paraparë *inter alia* me nenin 434 paragrafin 3 të KPPK-së. Gjykata pranon rëndësinë e rregullit sipas të cilit nëse vetëm mbrojtja ka paraqitur ankesë, gjykata mund të mos lëshoj vendim në dëm të të akzuarit. Kjo është shprehur në nenin 417 të KPPK-së në lidhje me aktgjykimet. Sidoqoftë, kjo nuk ka ndonjë rëndësi në këtë rast, siç është theksuar saktë nga Prokurori i shtetit, gjykata e shkallës së dytë vetëm ka plotësuar aktvendimin e Gjykatës së Qarkut duke dhënë detaje plotësuese të nxjerra nga shkresat e lëndës për bazën e caktimit të paraburgimit. Gjykata e shkallës së parë tanimë ka vendosur

⁹ Gjykata Supreme e Kosovës, aktvendimi Pn-Kr nr. 967.2012, 27 nëntor 2012, faqe 11, faqet 11-12



lidhur me atë bazë, p.sh., rreziku i ndikimit të dëshmitarëve sipas nenit 281 paragrafit 1 nën-paragrafit 2 (ii) të KPPK-së.¹⁰ Prandaj, ndalimi i *reformatio in peius* nuk është i aplikueshëm në këtë lëndë. Gjykata Supreme e Kosovës mendon se nuk është bërë asnjë shkelje e ligjit të procedurës nga gjykatat e shkallës së parë apo shkallës së dytë.

Po ashtu, kolegji i konsideron pretendimet e mbrojtjes pa merita në lidhje me shkeljet e nenit 281 paragrafit 1 nën-paragrafëve 1 dhe 2 (i) dhe (ii) të KPPK-së. Gjykata dëshiron të theksojë se ligji nuk kërkon elemente të fuqishme lidhur me kushtet e paraburgimit. Formulimi i nenit 281 paragrafit 1 nën-paragrafit 2 (i) dhe (ii) të KPPK-së ("tregon se ekziston rreziku i arratisjes", "ekzistojnë arsyet të besohet se ai apo ajo do t'i shkatërrojnë..") në mënyrë të qartë përcakton se standardi i provave është relativisht i ulët dhe se vërtetimi i ekzistimit të faktorëve të cilët tregojnë një rrezik të tillë është i kënaqshëm në këtë fazë të procedurës.

Gjykata Supreme pranon se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është shumë konciz. Kjo përbën një gabim të vogël të natyrës procedurale i cili nuk mund të ndikojë në rezultatin e procedurës penale. Megjithatë, ky kolegji i konsideron të mjaftueshme referencat specifike të bëra në këtë aktvendim në "aktvendimet e mëparshme mbi caktimin dhe vazhdimin e masave kundër të pandehurve dhe në aktvendimin mbi konfirmimin e aktakuzës në lidhje me ekzistimin e dyshimit të bazuar ..."¹¹ Për më tepër, gjykata e shkallës së parë në mënyrë specifike i është referuar aktvendimit të Gjykatës Supreme Ap-Kz nr. 453/2012 të datës 20 nëntor 2012.

Përveç kësaj, kolegji i poshtë nënshkruar pajtohet me mbrojtjen se arsyetimi 'stereotip' për vazhdimin e paraburgimit i cili nuk i referohet rrethanave individuale të lëndës, është jo adekuat.¹² Kolegji mendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një vlerësim të duhur të lëndës në dritën e kushteve të rrezikut të arratisjes duke thënë se "rëndësia e akuzave së bashku me dënimet potenciale të cilat do të mundë t'i shqiptohet të pandehurve (nëse shpallen fajtorë), kur merren së bashku janë të mjaftueshme për të vërtetuar rrezikun e arratisjes pa i marrë parasysh faktorët tjerë". Kryetari i kolegjit është dashur t'i marr parasysh dhe përmend faktorët e tjerë tanimë të përmendur në aktvendimet e mëparshme, në veçanti pasi që ata faktorë vazhdojnë të mbizotërojnë për secilin të pandehur.

Lidhur me argumentin e deklaratës së Gjykatës Supreme se nuk ka nevojë të diskutohet rreziku i arratisjes pasi që është përmbushur kushti tjetër sipas nenit 281 paragrafit 1 nën-paragrafit 2, kolegji i Gjykatës Supreme pranon se gjykata e shkallës së dytë është dashur të përgjigjet në pretendimet e mbrojtjes në lidhje me këtë pikë. Përkundër këtij lëshimi, kjo gjykatë pranon gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se ekzistojnë indikacione se katër të pandehurit mund të tentojnë të arratisen siç është përcaktuar me nenin 281 paragrafin 1 nën-paragrafin 2 (i) të Kodit.

Prandaj, kolegji i Gjykatës Supreme konsideron se karakteristikat personale të pandehurve të lartpërmendur siç është cekur në aktvendimin fillestar kanë vazhduar të ekzistojnë në kohën kur kryetari i kolegjit ka caktuar paraburgimin.¹³ Për këtë qëllim, i referohet aktvendimeve fillestare PPS nr. 07/10 dhe GJPP nr. 25/10 mbi paraburgimin dhe arrestin shtëpiak të datës 17 mars 2011, dhe aktvendimeve pasuese. Për më tepër, kolegji pajtohet me gjykatën e shkallës së parë se faktorët në vijim janë të lidhur me çështjen: pasi që lënda është kthyer në rigjykim, të pandehurit mund të konsiderojnë vetën në situatë më të keqe dhe mundësinë e të dënimit më të lartë; rëndësinë e veprave penale; dhe përballja me dënimin potencial.

¹⁰ Gjykata e Qarkut në Prishtinë, aktvendimi P nr. 766/2012, 24 nëntor 2012, faqe 3

¹¹ Gjykata e Qarkut në Prishtinë, aktvendimi P nr. 766/2012, 24 nëntor 2012, faqe 2

¹² Lënda GjEDNj-së Letellier kundër Francës, kërkesa nr. 12369/86, 26 qershor 1991, paragrafi 51; shih gjithashtu lëndën GjEDNj-së Yagci dhe Sarin kundër Turqisë, kërkesa nr. 16426/90, 08 qershor 1995, paragrafi 52; Lënda GjEDNj-së Stögmüller kundër Austrisë, kërkesa nr. 1602/62, 10 nëntor 1969, paragrafi 15

¹³ Lënda GjEDNj-së Becciev kundër Moldavisë, kërkesa nr. 9190/03, 4 tetor 2005, paragrafi 53

Në lidhje me argumentin e mbrojtjes se Gjykata e Qarkut ka bazuar gjetjet e saj në supozime dhe thashetheme, kolegji i poshtë nënshkruar e gjen si të pabazuar. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konsideron se gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar drejtë deklaratat e dëshmitarit X dhe indikacionet tjera që vërtetojnë rrezikun e ndikimit në dëshmitarët e mbetur siç parashihet me nenin 281 paragrafin 1 nën-paragrafin 2 (ii) të Kodit.

Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës refuzon kërkesën e mbrojtjes për ndërprejen e masës së paraburgimit ose shqiptimin e ndonjë mase më të butë.

Është vendosur si në dispozitiv.

Kryetar i kolegjit

Gjyqtar i EULEX-it Horst Proetel

Anëtar i kolegjit

Gjyqtar i Gjykatës Supreme Salih Toplica

Anëtar i kolegjit

Gjyqtar i Gjykatës Supreme Avdi Dinaj

Anëtar i kolegjit

Gjyqtar i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger


Anëtar i kolegjit

Gjyqtar i EULEX-it Martti Harsia

Procesmbajtëse

Zyrtare ligjore Chiara Rojek

**Gjykata Supreme e Kosovës
Pkl-Kzz nr. 188/2012
12 dhjetor 2012
Prishtinë**



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
**SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TACNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE**

Funëtori i autorizuar
Ovlaščeni radnik
